VENDIM
Nr. 127, datë 7.11.2013

MBI MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË TARIFAVE (TAP TARIFF CODE), TË PROPOZUAR NGA TAP AG, SIPAS DETYRIMEVE TË PËRCAKTUARA NË "OPINIONIN E PËRBASHKËT PËRFUNDIMTAR/FINAL JOINT OPINION"

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 6.11.2013,

Në zbatim të:

- Ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar;

- Vendimit nr. 39, datë 23.4.2012 për miratimin e "Udhëzuesit për menaxhimin dhe alokimin e kapaciteteve në projektin Trans Adriatik Pipeline (TAP), sipas paragrafit 6 të nenit 36 të direktivës 2009/73/EC", nëpërmjet të cilit ERE adaptoi direktivën 2009/73/EC, si bazë për shqyrtimin e mëtejshëm të aplikimit për përjashtime të TAP AG, së bashku me Autoritetin Rregullator të Energjisë të Italisë (AEEG) dhe Autoritetin Rregullator të Energjisë të Greqisë (RAE);

- Direktivës 2009/73/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin në vijim "Direktiva");

- Rregullores 713/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009 (në tekstin e mëtejmë "Rregullorja ACER");

- Rregullores 715/2009/CE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 13 korrik 2009;

- Vendimit nr. 27, datë 1.3.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP AG, prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41 (6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC për projektin Trans Adriatik Pipeline";

- Vendimit të Komisionit Evropian C(2013)2949 të datës 16 maj 2013;

- Opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) të datës 14 maj 2013;

- Vendimit nr. 64, datë 13.6.2013 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s "Për amendimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 27, datë 1.3.2013 "Për miratimin e përjashtimit të kushtëzuar të kompanisë TAP-AG, prej kërkesave të neneve 9, 32 dhe 41(6), (8) dhe (10) të direktivës 2009/73/EC, për projektin Trans Adriatik Pipeline", për marrjen në konsideratë të opinionit të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë (nr. 1/2013) dhe vendimit të Komisionit Evropian C(2013)2949", nëpërmjet miratimit të dokumentit "Opinioni përfundimtar i përbashkët i rregullatorëve të energjisë mbi aplikimin e TAP AG për përjashtim. Autoriteti për Energjinë Elektrike dhe Gazin (Itali), Enti Rregullator i Energjisë (Shqipëri) dhe Autoriteti Rregullator i Greqisë (Greqi)"/"Final Joint Opinion of the Energy Regulators on TAP AG's Exemption Application Autorita per l'Energia Elettrica e il Gas (Italy), Enti Rregullator i Energjisë (Albania) and Regulatory Authority of Greece (Greece)";

- Kërkesës së TAP AG të datës 11 tetor 2013 protokolluar prej ERE-s me nr. prot. 500/11 për miratimin e metodologjisë së tarifave (referuar ndryshe si "TAP Tariff Code"). E njëjta kërkesë i është paraqitur njëkohësisht dhe në të njëjtën formë edhe autoriteteve rregullatore të Italisë (AEEG) dhetë Greqisë (RAE).

Duke marrë në konsideratë se:

- Shoqëria TAP AG, mbështetur në nenin 40, pika 5 të ligjit nr. 9946, datë 30.6.2008 "Për sektorin e gazit natyror", të ndryshuar, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Energjisë (në vijim "ERE)" një kërkesë për përjashtim, duke iu referuar një projekti për një *interconnector* të ri që përshkon Greqinë, Shqipërinë dhe përfundon në Itali (në vijim "Gazjellësi TAP") dhe kjo sjell që për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për përjashtim, të nevojitet përfshirja e autoriteteve rregullatore homologe (në vijim "autoritetet"); për Shqipërinë, Enti Rregullator i Energjisë (ERE), për Greqinë, Regulatory Authority for Energy (RAE) dhe për Italinë, Autorita per L'Energia Elettrica e il Gas (AEEG);

- Kërkesa e sipërcituar përfshinte ndërmjet të tjerave, një kërkesë për përjashtim nga aplikimi i nenit 41, pika 6, 8 dhe 10 të direktivës 73/09 (kërkesë për përjashtim nga tarifat e rregulluara) në lidhje me:

a) Kapacitetin e plotë transportues (që përfshin së bashku kapacitetin e përjashtuar nga detyrimi prej së drejtës së aksesit të palëve të treta sipas parashikimeve të nenit 32 të direktivës, si dhe kapacitetin subjekt i një detyrimi të tillë); dhe

b) Kohëzgjatjen e përjashtimit për një periudhë 25-vjeçare që nga hyrja në operim e gazsjellësit dhe fillimi i tregtimit të të gjitha produkteve të kapacitetit në drejtimin normal lindje-perëndim (referuar më tej "*forward flow*") dhe ato në drejtim të kundërt perëndim-lindje (referuar më tej "*reverse flow*");

- Me vendimin nr. 27, datë 1.3.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s ka miratuar Joint Opinion/opinionin e përbashkët. Ky vendim ishte rezultat i vlerësimit të përbashkët pozitiv i autoriteteve rregullatore përgjegjëse për energjinë të Shqipërisë (ERE), të Italisë (AEEG) dhe të Greqisë (RAE). Ky vendim, në përputhje me legjislacionet përkatëse, iu dërgua për vlerësim Komisionit Evropian nga ana e AEEG dhe RAE dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë nga ana e ERE-s;

- Me vendimin nr. 64, datë 13.6.2013, Bordi i Komisionerëve të ERE-s miratoi të gjitha rekomandimet shtesë të paraqitura nga ana e Komisionit Evropian dhe nga ana e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, lidhur me pjesën 4 të opinionit të përbashkët (Final Joint Opinion/opinioni i përbashkët përfundimtar). I njëjti vendim u miratua edhe prej rregullatorëve AEEG dhe RAE;

- Opinioni i përbashkët përfundimtar/Final Joint Opinion parashikon përjashtimin e TAP AG nga tarifat e rregulluara, konkretisht për produktet *forward flow*, për gjithë kapacitetin e transportit të gazsjellësit (që përfshin kapacitetin e përjashtuar nga aksesi i palëve të treta dhe kapacitetin që është subjekt i këtij detyrimi), për një periudhë 25-vjeçare, por në këtë përjashtim nuk përfshihen produktet e *reverse flow*, për të cilat vendimi parashikon aplikimin e një tarife, vlera e së cilës nuk mundet të jetë më e lartë se 5% e tarifës së produktit korrespondues të *forward flow*, sipas parashikimeve të paragrafit 4.4 të Final Joint Opinion;

- Gjithashtu, sipas paragrafit 4.2 pika 1 e Final Joint Opinion, dhënia e përjashtimit nga tarifat e rregulluara për produktet *forward flow* sanksionohet edhe me plotësimin e disa kushteve. Këto kushte parashikojnë që:

a) Metodologjia e tarifave që do të aplikohet nga TAP AG do të jetë subjekt i aprovimit të përbashkët të autoriteteve;

b) Tarifat duhet të jenë koherente me parimet e formuluara në vendimin e autoriteteve për përjashtim (Final Joint Opinion), që përfshin ndërmjet të tjerave aplikimin e së njëjtës tarifë për të njëjtin produkt, pavarësisht nëse ai është i ofruar prej kapacitetit të përjashtuar nga aksesi i palëve të treta apo prej kapacitetit jo të përjashtuar;

c) Metodologjia e tarifave të përbëjë një strukturë tarifore të tipit hyrëse-dalëse/"*entry-exit*". Ajo duhet të përmbajë mekanizmat e përcaktimit të çmimeve për llojet e ndryshme të produkteve në drejtimin *forward flow*, që kanë kohëzgjatje të ndryshme, janë të vazhdueshme ose që mund të ndërpriten dhe në vartësi të pikës së hyrjes (*entry point*) dhe të daljes (*exit point*);

d) Tarifa duhet të reflektojë kostot efikase, të jetë transparente dhe jodiskriminuese;

e) Tarifat duhet të jenë zbritëse në vijim të rritjes së kapaciteteve transportuese që do të përdoren;

f) Tarifa duhet të konsiderojë nivelin e ndryshëm të riskut të investimit fillestar dhe atë të zgjerimit të mëtejshëm të kapacitetit.

- Paragrafi 4.2, pika 1 e Final Joint Opinion, i atribuon autoriteteve edhe detyrën e monitorimit të vazhdueshëm, në mënyrë që tarifa e aplikuar nga TAP AG të jetë në përputhje me metodologjinë e tarifave të miratuara. TAP AG duhet të bashkëpunojë me autoritetet për këtë qëllim;

- Shoqëria TAP AG, me letrën e datës 11 tetor 2013, në kuptim të pikës 4.2, pika 1 të Final Joint Opinon, ka paraqitur pranë ERE-s një propozim të dokumentit të metodologjisë së tarifave, TAP Tariff Code. E njëjta kërkesë në të njëjtën kohë dhe e shoqëruar nga i njëjti dokument i është paraqitur për miratim edhe autoriteteve rregullatore të Italisë (AEEG) dhe të Greqisë (RAE);

- TAP Tariff Code është në përputhje me parashikimet e Final Joint Opinion sikurse cituar më sipër (germat "a"-"f" më sipër).

Si dhe duke konstatuar se:

- Dokumenti i TAP Tariff Code, sikurse dorëzuar nga TAP AG, paraqet megjithatë disa dispozita, formulimi i të cilave është jo mjaftueshëm i detajuar, dhe si i tillë mund të japë shkas për interpretime të

ndryshme. Ky qëndrim ndahet edhe prej autoriteteve rregullatore të Italisë (AEEG) dhe të Greqisë (RAE);

- Është e përshtatshme të përcaktohet mënyra e monitorimit të përbashkët prej autoriteteve, sipas paragrafit 4, pika 1 e Final Joint Opinion;

- Është e përshtatshme që shoqëria TAP AG të publikojë TAP Tariff Code së bashku me modifikimet e kërkuara në aneksin A;

- Është e nevojshme që çdo amendim eventual i TAP Tariff Code të jetë objekti i miratimit të përbashkët prej autoriteteve;

- Megjithëse TAP Tariff Code ka përfshirë kërkesat e paragrafit 4.2, pika 1 e Final Joint Opinion, është e përshtatshme vendosja e disa rishikimeve të vogla në aneksin A, që synojnë:

a) Të rrisin nivelin e transparencës dhe informacionit ndaj *shippers*;

b) Të sqarojnë që kostot për ndërtimin e pikave të reja *entry/exit* janë në ngarkim të palës së interesuar në vendin ku kërkohet të ndërtohet pika e re në përputhje me legjislacionin dhe rregullat e vendit përkatës dhe jo të TAP AG;

c) Të saktësojnë më tej kriteret bazë të modelit të llogaritjes së tarifave, veçanërisht ato që lidhen me mekanizmin që siguron qëndrueshmërinë apo uljen e nivelit të tarifave edhe në rastin e ndryshimit të nivelit të kapacitetit të përdorur;

d) Të përcaktojnë mënyrën e amendimit të metodologjisë së TAP Tariff Code në rastin kur mund të ofrohen produkte kapaciteti të reja nga ato të parashikuara fillimisht.

VENDOSI:

1. Të miratojë metodologjinë e tarifave, TAP Tariff Code, bashkëlidhur këtij vendimi (aneksi B), të propozuar nga shoqëria TAP AG me shkresën e datës 11 tetor 2013 dhe të protokolluar prej ERE-s, me nr. prot. 500/11, me kusht që aneksi A, gjithashtu, bashkëlidhur këtij vendimi të jetë pjesë përbërëse e TAP Tariff Code dhe të trajtohet si pjesë integrale e tij.

2. TAP AG duhet të publikojë TAP Tariff Code përfshirë aneksin A.

3. Njoftimin e TAP AG për marrjen e këtij vendimi.

4. Njoftimin e autoriteteve rregullatore të energjisë të Italisë (AEEG) dhe të Greqisë (RAE) për marrjen e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti